

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Valon Berisha dhe Fidan Aliti i japin fund aventurës me Kosovën
ADRESA	https://albeu.com/sport/valon-berisha-dhe-fidan-aliti-i-japin-fund-aventures-me-kosoven/1017429/
BURIMI	albeu.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	18 shtator 2026, 12:57:49 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	18 shtator 2026, 12:55:53 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	ad74d43064481e2876cc6105f674e2cfbd0c8d6b3e25d33763da03ac64b91a26
TEKSTI	50e5f43903e9cc345a7f86166bcc28464882350c8466633a02125e53512e303b
PAMJA	27fb37b62d3af49ef06acb2eb01bb7295d522d3a0b73c02fe4235b3892a7a8f2

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	da3a93d2af004726051fcca944884c18f2f5575909887a9267965c86a6cb8e1b
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	c2d3424a52af1d7a5bda261c525771941165d93d82c499297c4e9de151b879e4
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/da3a93d2af004726051fcca944884c18f2f5575909887a9267965c86a6cb8e1b>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Valon Berisha dhe Fidan Aliti i japin fund aventurës me Kosovën



Federata e Futbollit të Kosovës (FFK) ka bërë të ditur se Valon Berisha dhe Fidan Aliti nuk do të vazhdojnë më të jenë pjesë e Kombëtares së Kosovës, pas një periudhe të gjatë kontributi me fanellën e "Dardanëve".

Berisha, i cili zgjodhi të largohej nga Norvegjia për të përfaqësuar Kosovën, e ka cilësuar këtë hap si një prej vendimeve për të cilat do të ndihet krenar gjatë gjithë jetës.

Ai ka rrëfyer se e ka të vështirë të gjejë fjalët e duhura për të përshkruar emocionet dhe krenarinë që lidhen me këtë moment. Sipas tij, gjithçka nisi me një djalë shqiptar të rritur në mërgim, i cili kishte dy ëndrra të mëdha: Kosovën dhe futbollin.

Berisha ka theksuar se familja dhe prindërit e tij i mbollën që në fëmijëri dashurinë për vendin, familjen dhe prejardhjen e tij, duke e udhëhequr drejt përbushjes së këtyre dy ëndrrave.

Pas shumë vitesh, ai shprehet se ndihet thellësisht krenar dhe mirënjohës ndaj familjes, prindërve dhe Zotit, që i dhanë mundësinë të realizonte synimin për ta ngritur emrin e Kosovës përmes futbollit.

Gjatë kësaj periudhe, Berisha zhvilloi 52 ndeshje dhe shënoi disa gola. Mes tyre, ai ndaj Finlandës do të mbetet përgjithmonë i regjistruar në historinë e futbollit të Kosovës. Tashmë, sipas tij, ka ardhur momenti për ta mbyllur kapitullin si futbollist aktiv i Kombëtares.

Dhjetë vite më parë, Berisha mori vendimin për t'iu bashkuar Kosovës, edhe pse shprehu mirënjohje për Norvegjinë, shtetin që i kishte ofruar atij dhe familjes së tij mundësinë për një jetë më të mirë.

Ai ka treguar se zgjedhja për të përfaqësuar Kosovën erdhi nga dëshira e fortë për të nderuar prejardhjen e tij dhe për t'i bërë krenarë prindërit. Bashkë me bashkëlojtarët e gjeneratës së tij, Berisha tha se ndihmoi në ndërtimin e rrugëtimit të Kombëtares, me shpresën që brezat e rinj ta vazhdojnë këtë rrugë, të besojnë dhe të

të fundit /



Valon Berisha dhe Fidan Aliti i japin fund aventurës me Kosovën



E transportonin sa herë ndërronin banesë"/ Çifti ruajti trupin e foshnjë...



Studentët e UP-së të hënën marshojnë kundër vendimit të...



Bashkim Krasniqi merr detyrën e zëvendësministrit në...



Deputeti belg Michel De Maegd pret Marjana Koçekun në Parlame...



M.A. dënohet me 8 vjet burgim nga Gjykata Themelore në Mitrovicë



Macron: Sulmet hibride ruse ndaj Francës janë intensifikuar, "natyra ...



ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

qëndrojnë të bashkuar për synime edhe më të mëdha.

Edhe Fidan Aliti ka njoftuar se po e mbyll kapitullin e tij me ekipin kombëtar, një vendim që, sipas tij, ka qenë i vështirë për t'u marrë.

Pas shumë vitesh, ndeshjesh, emocionesh, sakrificash dhe kujtimesh të çmuara, mbrojtësi ka vendosur të largohet nga futbolli i përfaqësueses së Kosovës.

Aliti ka thënë se veshja e fanellës së Kosovës ka qenë dhe do të mbetet një prej nderimeve më të mëdha të jetës së tij. Në çdo paraqitje, ai është shprehur se ka dhënë gjithçka për këtë fanellë, duke luajtur me krenari dhe përgjegjësi të plotë për peshën që mbart përfaqësimi i vendit.

Ai ka kujtuar se me Kosovën ka përjetuar fitore e festa, por edhe zhgënjime pas humbjeve. Së bashku, sipas Alitit, kanë luftuar, kanë ëndërruar dhe kanë lënë një gjurmë të rëndësishme në historinë e futbollit të Kosovës.

Edhe pse nuk do të jetë më futbollist i Kosovës, Aliti ka theksuar se do të mbetet gjithmonë tifoz i saj. Ai ka nënvizuar se Kosova do të jetë përherë pjesë e tij dhe prioriteti i parë sa herë që vendi të ketë nevojë për të.

"Faleminderit për gjithçka, Kosovë. Ishte ëndërr, u bë nder dhe krenari", ka përfunduar Aliti.

Shtuar më 18.09.2026 14:55

Tags: [Fidan aliti](#), [Kombëtarja e kosovës](#), [valon berisha](#)



Tri prurje të reja dhe disa mungesa në listën e Kosovës për Ligën e...



Dinamo kërkon fitoren e katërt radhazi, Ilir Daja vlerëson Laçin dhe kërko...



Xavi shpall grumbullimin e parë me Holandën, Zechiel dhe Van Bommel marrin...



Cristiano Ronaldo vazhdon me Portugalinë, grumbullohet për Ligën e...



Shqipëria U-17, publikohet lista për dy miqësoret e shtatorit ndaj Malit të Zi



Harry Kane: Reali është favorit për Ligën e Kampionëve dhe me...



Wolfsburgu zyrtarizon mungesën e Elvis Rexhepajt në grumbulli...



VIDEO/ Jasir Asani shkëlqen në Champions-in aziatik, faqja zyrtare...



© 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko...

Kërko

Kryesore

[Erion Veliaj](#)
[Free Esim](#)
[Zgjedhjet 2025](#)
[Belinda Balluku](#)
[SPAK](#)
[Kombëtarja](#)

Kategori

[Lifestyle](#)
[Showbiz](#)
[Tech](#)
[Shëndetësi](#)
[Argetim](#)
[Enciklopedi](#)

Linqet

[Live tv shqiptare](#)
[Moti në Shqipëri](#)
[Travel](#)
[Horoskopi](#)
[Livescore](#)
[News from Albania](#)

Tags

[Edi Rama](#)
[Albania News](#)
[Ilir Meta](#)
[Piranjat](#)
[gazeta, tv, portale](#)
[Sali Berisha](#)

Moti

[Moti në Tiranë](#)
[Moti në Prishtinë](#)
[Moti në Shkup](#)
[Moti në Durrës](#)
[Moti në Prizren](#)
[Moti në Tetovë](#)

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.